



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



### ***THIRRJE PUBLIKE***

### ***PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE PËR SHËRBIME SOCIALE***

#### **Udhëzimet për Aplikantët**

Data e hapjes së thirrjes: **13 shtator, 2021**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: **01 tetor, 2021**

## **Përbajtja**

<b>1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE PËR SHËRBIME SOCIALE .....</b>
1.1 PROBLEMET TË CIALAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE .....
1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE .....
1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES .....
<b>2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES .....</b>
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?.....
2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit .....
2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes .....
2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes.....
2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme.....
2.4.2 Shpenzimet e papranueshme.....
<b>3. SI TË APLIKONI?.....</b>
3.1 Forma e përshkruese e projektpropozimit.....
3.2 Përbajtja e formës Buxhetit.....
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin? .....
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve.....
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje? .....
<b>4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE .....</b>
4.1 Aplikacionet e pranuara do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....
4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi .....
<b>5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES .....</b>
<b>6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE .....</b>

## 1. THIRRJE PUBLIKE PËR SUBVENCIONIM TË SHËRBIMEVE SOCIALE

### 1.1 PROBLEMET TË CIALAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Komuna e Prishtinës e ka përgatitur platformën e saj për mirëqenie sociale PRISHTINA E SECILIT. Kjo platformë është një tërësi e masave konkrete që për qëllim përfundimtar kanë avancimin e fuqizimin e pjesëtarëve të komuniteteve të njerëzve të marginalizuar, diskriminuar e rrezikuar të shoqërisë sonë. Target grupet e platformës janë:

- Familjet me asistencë sociale;
- Të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar;
- Gratë dhe fëmijët në situata të rënda sociale;
- Të moshuarit;
- Minoritetet etnike;
- Komuniteti LGBT; dhe
- Përdoruesit e substancave narkotike.

Për secilën prej kategorive të lartcekura, platforma do prodhojë masa konkrete në drejtim të krijimit të infrastrukturës së nevojshme materiale e njerëzore asisoj që të krijohet një rrjetë e fuqishme mbrojtëse për banorët tonë brenda këtyre kategorive. Platforma do krijojë hapësirat e nevojshme përmes së cilave do krijohet mundësia e ofrimit të disa shërbimeve publike me qëllim që të arrihet një nivel optimal i ndihmës komunale për pjesëtarët e këtyre komuniteteve shoqërore. Gjithashtu, platforma do jetë krijojë korpusin e nevojshëm profesional të shërbysesve social përmes bashkëpunimit me organizata të specializuara të shërbimit psikosocial asisoj që t'i përgjigjemi nevojave bazike sociale në Prishtinë. Tutje, platforma do mbështes aktivitete të caktuara shoqërore përmes së cilave do rritet ndjenja e përkatësisë komunitare e për pasojë edhe avancimi e fuqizimi i këtyre pjesëtarëve të shoqërisë e po ashtu njëkohësisht do rritet niveli i pranueshmërisë së këtyre pjesëtarëve nga pjesa tjetër shumicë e shoqërisë.

### 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi/objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje janë:

*Ofrimi i shërbimeve sociale*

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

Ofrimi i shërbimeve sociale grupet e platformës të cilat janë:

- Familjet me asistencë sociale;
- Të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar;
- Gratë dhe fëmijët në situata të rënda sociale;
- Të moshuarit;

- Minoritetet etnike;
- Komuniteti LGBT; dhe
- Përdoruesit e substancave narkotike.

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë:

*OJQ qe veprojnë ne Komunën e Prishtinës.*

## 1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES

1. Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej **350,000.00€ (treqind e pesëdhjetë mijë euro)**.
2. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **500 € (pesëqind euro)**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **14,000.00 € (katërmëdhjetë mijë euro)**.

## 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

### 2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. OJQ-të aplikuese të janë të regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike .
2. Të jetë e pajisur me Numër Fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.
3. OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së .
4. OJQ-ja nuk është në procedurë të shuarjes dhe çregjistrimit.
5. OJQ-ja të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete.
6. OJQ-ja nuk do të përfitojë subvencione nga thirrja për mbështetje financiare, në qoftë se e njëjtë ka të nënshkruar një Memorandum Bashkëfinancimi me komunën, në të njëtin vit kalendarik/buxhetor.
7. Të gjithë aplikuesit që i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Prishtinës.

### **2.1.1 Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrje:**

1. OJQ-të e falimentuara;
2. OJQ-të të cilat kanë dështuar të kryejnë detyrimet tatimore dhe kontributet tjera sipas legislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
3. OJQ-të të cilat mund të kenë konflikt interesit;
4. Të gjithë aplikuesit që nuk i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Prishtinës;

Numri i projekteve me të cilat mund të aplikoj një OJQ:

1. Një aplikant mund të paraqesë vetëm një kërkesë për aplikim.

### **2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit**

Për zbatimin e projektit nuk është e detyrueshme ekzistenza e partneritetit me organizata të tjera por e njëjtë është e dëshirueshme.

1. Në rast të ekzistencës së partneritetit, partnerët Aplikanti duhet të veprojnë në partneritet me të paktën {një} OJQ e cila ushtron aktivitetin në Komunën e Prishtinës ku zbatohet projekti;

Kushtet që duhet ti plotësojnë partnerët në projekt:

2. Partnerët duhet të përbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për aplikuesit, siç është paraparë në pikën 2.1 të këtyre udhëzimeve.

Raporti në mes të Aplikantit dhe partnerëve:

3. Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere. Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit, e cila duhet të dorëzohet në kopje origjinale të nënshkruar nga secili partner në projekt.

### **2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

1. Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është prej 13.09.2021 deri më 12.08.2022.
2. Aktivitete e projektit duhet të kryhen brenda territorit të Komunës së Prishtinës.

3. Aktivitetet ne ofrimin e shërbimeve sociale, OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën mbrojtjes së grupeve të Platformës për Mirëqenie Sociale PRISHTINA E SECILIT si në vijim: Familjet me asistencë sociale, Të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, Gratë dhe fëmijët në situata të rënda sociale, Të moshuarit, Minoritetet etnike, Komuniteti LGBT dhe Përdoruesit e substancave narkotike.

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

1. Aktivitetet që nuk zhvillohen në Komunën e Prishtinës;
2. Aktivitetet që përmbajnë diskriminim gjinor, racor dhe fetar;

## 2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

### 2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Organizimi i aktiviteteve që ofrojnë mbështetje për personat e moshuar, fëmijët, viktimat e dhunës ne familje, trafikimit ,ofrimi i shërbimeve ditore terapeutike, fuqizimi dhe zhvillimi profesional, ofrimi i strehimit dhe mbrojtja e drejtave te grave dhe te rinjve, trajtimi dhe përkujdesi për të moshuar, komunitetin LGBT, minoritetet etnike dhe abuzuesit me substancë narkotike.
2. Shpenzimet e furnizimit me ushqime dhe medikamente për persona që janë të strehuar dhe marrin shërbime të ndryshme social edhe familjare;
3. Shpenzimet e furnizimit me material higjenik për nevoja të personave që marrin shërbime nga projekti;
4. Shpenzimet e stafit menaxherial dhe profesional të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke u bazuar në llojin e shërbimeve që ofrojnë dhe kohën e ndarë për zbatimin e aktiviteteve për projektin;

5. Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe partnerët e përfshirë në projekt, duke specifikuar kategoritë e profesionistet të angazhuar, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
6. Shpenzimet e qirasë për zhvillimin e aktiviteteve dhe ofrimit të shërbimeve në lokalet relevante;
7. Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj);
8. Shpenzimet edukative dhe të aftësimit profesional për kategoritë përfituese që janë pjesë e projektit;
9. Shpenzimet e organizimit të aktiviteteve dhe këshillime psiko-sociale për kategoritë përfituese që janë pjesë e projektit;
10. Shpenzimet e transportit dhe derivateve, të cilat janë të planifikuara për qëllim të ngrohjeve apo vizitave në teren dhe familje;
11. Shpenzimet e komunalive (ujë, mbeturinat, energjia elektrike dhe ngrohje) dhe mirëmbajtjes, për projektet të cilat zhvillojnë aktivitete të qëndrimit rezidencial apo ditor;

#### **2.4.2 Shpenzimet e papranueshme**

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

1. Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
2. Shpenzimet e interesit për borxhin dhe kamatat;
3. Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
4. Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
5. Pagesa e bonuse për punonjësit;
6. Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

### **3. SI TË APLIKONI?**

*Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:*

1. Formulari i projekt-propozimit;
2. Formulari i propozim buxhetit;
3. Formulari i deklaratës së partneritetit;
4. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
5. Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal;
6. Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë (OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal);
7. Forma e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të finançuara nga burimet publike të finansimit;
8. Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik, OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistencë e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikoj në implementimin e projektit, prandaj, zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme;
9. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore – kërkohet originali jo më i vjetër se 30 ditë;
10. Dëshminë e xhirologarisë aktive të aplikuesit në njëren prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovë;
11. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi;

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarfe të myllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit original të kërkuar, si dhe një kopje elektronike në

CD. Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

### **3.1 Aplikacioni i projekt propozimit**

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikusin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

### **3.2 Përbajtja e formës Buxhetit**

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përbaj informacion pér të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar pér financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

### **3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?**

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të myllur.

Aplikimi original duhet të dërgohet me postë ose në person (dhe të dorëzohet në Zyrën përkatëse). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin "Të mos tē hapet para takimit të Komisionit Vlerësues"

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

*Komuna e Prishtinës  
Drejtoria e Mirëqenies Sociale  
Rr, UCK nr 2, 10000,Prishtinë  
Qendra për shërbime me Qytetarë  
Kati I sporteli nr.3  
"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues"*

### 3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është 15 ditë pune nga data e hapjes së thirrjes dhe zgjatë deri më **01 tetor 2021**, deri në orën 15:00.

Aplikacioni i dorëzuar brenda periudhës së thirrjes gjithashtu pranohet nëse vula pranuese tregon se është dorëzuar në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

### 3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: [munavere.qerkezi@rks-gov.net](mailto:munavere.qerkezi@rks-gov.net), jo më vonë se 8 ditë para skadimit të thirrjes.

## 4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

### 7.1 Aplikacionet e pranuara do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Komuna e Prishtinës do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë

nga zyrtar të institucionet dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuara, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Komuna e Prishtinës do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Lista e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshëm të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kaloj shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartoj listën rezervë të projekteve/programeve.

## 4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shhangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, Komuna e Prishtinës do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës *10 ditë*, aplikimi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

**Njoftimi i aplikuesve** - Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve në kuadër të thirrjes.

## 8. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes (vendosni datat)

1. Afati i fundit për aplikimet (**01.10.2021**)
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen (**22.09.2021**)

Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit e mëposhtme: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/ose/prishtinaonline.com>.

## 9. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

### FORMULARËT

*Listo të gjithë formularët e nevojshëm të paraparë sipas rregullores dhe manualit për implementimin e saj p.sh.*

1. *Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (formulari të shkarkohet nga linku);*
2. *Formulari i Propozim buxhetit (formulari të shkarkohet nga linku);*
3. *Formulari i Deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (formulari të shkarkohet nga linku);*
4. *Formulari i Raportit Financiar (formulari të shkarkohet nga linku);*
5. *Formulari i Raportit narrativ-përshkrues (formulari të shkarkohet nga linku);*
6. *Formulari i Deklaratës së projekteve te finançuara (formulari të shkarkohet nga linku);*
7. *Formulari i Deklaratës së partneritetit (formulari të shkarkohet nga linku).*